

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ukraina përgatitet për një dimër të ashpër ndërsa sulmet ruse godasin ekonominë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/ukraina-pergatitet-per-nje-dimer-te-ashper-ndersa-et-rus-e-godasin-ekono-i585729
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 07:31:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 07:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1f7e43c01967353f995dfba74eec806f6b9c0b87b49b3d5dd9876896e9aaa9a1
TEKSTI	1d090257b84b20bafa537d53289449f679d19c44bc60d93c64a76c936cf00dc3
PAMJA	ab95c0245a2f444c2058179041105cf616882c0e38b10225b32dcfc421e26f3a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	279107c684791ff91d5893c17a37c669400e6b7ddd020932b07b1c924a4f458a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4dbb247c3ea631ff8f2707e6b1f894f950e04cf248d4447a7ba057e4086fe8b1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/279107c684791ff91d5893c17a37c669400e6b7ddd020932b07b1c924a4f458a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Ukraina pergatitet per nje dimër të ashpër ndërsa sulmet ruse godasin ekonominë](#)[Rikthim emocionues per Celine Dion, koncerti i pare i plote pas me shume se gjashte v fundit](#)

Ukraina përgatitet për një dimër të ashpër ndërsa sulmet ruse godasin ekonominë



13 Shtator 2026, 09:30Bota TEMA



Ukraina po përgatitet për një dimër të rëndë, pasi sulmet e shtuara ruse ndaj infrastrukturës dhe industrive kryesore të eksportit po e përkeqësojnë krizën buxhetore, deklaruan të shtunën zyrtarë ukrainas.

Ministri i Ekonomisë, Oleksandr Kravchenko, tha se dëmet në infrastrukturë dhe asetet fikse nga sulmet ajrore ruse vlerësohen në afro 10 miliardë dollarë për këtë vit, ndërsa kostot më të gjera ekonomike të sulmeve dhe bllokimi de facto i porteve të vendit përlogariten në rreth 1.5 pikë përqindjeje të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

"Parashikojmë një dimër shumë të vështirë, si për sa i përket infrastrukturës kritike – e cila po shkatërrohet çdo ditë nga sulmet ruse – ashtu edhe për sa u përket kushteve të përgjithshme ekonomike në vend", tha Kravchenko.

"E gjithë kjo ndodh në një kohë kur buxheti dhe hapësira fiskale janë shumë të kufizuara", u tha ai investitorëve, zyrtarëve dhe diplomatëve në konferencën YES në Kiev.

Ndërsa luftimet në vijën e frontit kanë ngecur kryesisht pas më shumë se katër vitesh e gjysmë lufte në Ukrainë, Rusia dhe Ukraina kanë shënjestruar gjithnjë e më shumë rrjetet logjistike dhe asetet e tjera ekonomike, në përpjekje për të dobësuar kapacitetet luftarake të njëra-tjetrës.

Prej më shumë se dy javësh, Rusia ka kryer sulme pothuajse të vazhdueshme ndaj Kievit duke përdorur dronë më të shpejtë me motorë reaktivë, duke çrregulluar jetën e përditshme, biznesin dhe funksionimin e institucioneve qeveritare.

Si Rusia, ashtu edhe Ukraina, mohojnë se shënjestrojnë qëllimisht civilët gjatë sulmeve ajrore.

Moska gjithashtu ka bllokuar efektivisht portet ukrainase në Detin e Zi, duke intensifikuar sulmet ajrore ndaj rajoneve jugore të vendit.

Rreth 40 miliardë dollarë të ardhura nga eksporti janë në rrezik si pasojë e bllokadës, tha Kravchenko.

Produktet kryesore të eksportit të Ukrainës – produktet bujqësore, si dhe hekuri e çeliku – transportohen përmes porteve të saj në Detin e Zi.

Ndërkohë, ndërsa sulmet ruse dëmtojnë infrastrukturën dhe industrinë, të ardhurat e brendshme buxhetore kanë filluar të vihen nën presion.

Të ardhurat e brendshme ishin 1.35 miliard dollarë në nivelin e parashikuar gjatë tetë muajve të parë të vitit, ku një e katërta e këtyre humbjeve u regjistrua vetëm në muajin gusht, tha Roksolana Pidlasa, kryetare e komisionit parlamentar për buxhetin.

Ajo theksoi se lufta po bëhet gjithnjë e më e kushtueshme dhe se Ukraina nuk mund t'i financojë më plotësisht nevojat e saj për mbrojtje përmes burimeve të brendshme, siç kishte bërë në vitet e mëparshme.

Ukraina shpenzoi rreth 42 miliardë dollarë për mbrojtjen e saj në tetë muajt e parë të vitit, duke përjashtuar ndihmën ushtarake në formë materiale.

Megjithatë, gjenerimi i të ardhurave të brendshme dhe huamarrja vendase siguruan vetëm 39 miliardë dollarë gjatë kësaj periudhe, tha Pidlasa.

“Fatkeqësisht, këtë vit lufta është bërë aq e kushtueshme, sa që nuk mund të mbulojmë dot as pjesën tonë të shpenzimeve”, tregoi ajo në konferencë.

Kostoja ditore e luftës u rrit në rreth 190 milionë dollarë këtë vit, krahasuar me 140 milionë dollarë në vitin 2023, për shkak të inflacionit, shtimit të numrit të trupave, rritjes së pagesave sociale për familjet e ushtarëve të rënë dhe konsumit më të lartë të municioneve, shtoi ajo.

Ukraina përballlet me një deficit shtesë financimi për mbrojtjen e saj deri në fund të këtij viti. Qeveria po kërkon mënyra për të shkurtuar ose shtyrë shpenzimet buxhetore jo-ushtarake dhe po negocion me partnerët përëmdimorë për më shumë mbështetje financiare, por deri më tani nuk është gjetur asnjë zgjidhje e qartë dhe e shpejtë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Zgjedhje vendimtare në Suedi, ekstremi i djathtë vetëm një hap larg pushtetit](#)

09:10 Bota

[Qindra emigrantë të dëbuar nga Britania zhduken në Francë, Parisi kërkon anulimin e marrëveshjes dypalëshe](#)

08:30 Bota / 2 komente

[Dalja e trenit nga shinat në Normandi, dyshohet për sabotazh](#)

08:11 Bota / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.